KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS - TUŽILAČKI SAVET KOSOVA
SEKRETARIATI - SEKRETARIJAT
ARKIVA - ARHIVA
23-12-2025
Nr./Br. 2295 /2025
PRISHTINË - PRIŠTINA

KPK/nr. 1169 /2025
Datë: 11.12.2025

Këshilli Prokurorial i Kosovës [KPK],
Në mbështetje të nenit 7 të Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 12 [par.4/a] të Ligjit nr.08/L-249 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, lidhur me n.14 të ligjit bazik, nenit 53, 54 [par.1, nënpar.1.2], 56 [par.1, nënpar.1.1] të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe të nenit 4 të Rregullores nr.02/2022 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit, në Takimin e 280-të të mbajtur me datë 11.12.2025, mori:

V E N D I M
[për anulimin e Konkursit dhe Procesit të rekrutimit të prokurorëve të shtetit]

1. Anulohet Konkursi dhe Procesi i rekrutimit të 21 [njëzetenjë] Prokurorëve të Shtetit në Prokuroritë Themelore të Republikës së Kosovës, i shpallur me Vendimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës **KPK/nr.311/2025,** të datës 30.04.2025.

2. Këshilli rezervon të drejtën që pas vlerësimit të tërësishëm të nevojave të sistemit prokurorial, ta rishpallë konkursin në formë të rishikuar, në përputhje me nevojat e sistemit prokurorial dhe legjislacionin në fuqi.

3. Obligohet Sekretariati që ta publikojë këtë vendim në faqen zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës, brenda 15 [pesëmbëdhjetë] ditëve.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

A r s y e t i m

Këshilli Prokurorial i Kosovës [KPK] në Takimin e 266-të, të mbajtur më 30.04.2025, me Vendimin **KPK/nr.311/2025 kishte** shpallur Konkurs publik për rekrutimin e 21 [njëzetenjë] Prokurorëve të Shtetit në Prokuroritë Themelore të Republikës së Kosovës.

KPK, në këtë Takim dhe në zbatim të Konkursit, me Vendimin **KPK/nr.312/2025** kishte themeluar Komisionin për Rekrutimin e Prokurorëve të Shtetit, ndërsa me Vendimin **KPK/nr.313/2025** themelimin e Komisionit për Rishqyrtim.

Konkursi ishte shpallur pas analizës për identifikimin e nevojave të sistemit prokurorial, përkatësisht të Prokurorive Themelore të Kosovës, për prokuoror të rinj, bazuar në parimet e profesionalizimit, integritetit, mosdiskriminimit, transparencës, pavarësisë, paanshmërisë, meritokracisë dhe pasqyrimit shumetnik dhe gjinor, siç është përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, instrumentet ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut si dhe në ligjet e aplikueshme në vend.

Me datë 26.07.2025 Komisioni për Rekrutim ka organizuar dhe mbajtur Testin kualifikues me të gjithë kandidatët e zgjedhur të cilët i kishin përmbushur kushtet e përcaktuara në Rregullore dhe Konkurs, ndërsa me datë 05.10.2025, ka mbajtur Testi me shkrim.

Pas kalimit të fazës së Testit kualifikues dhe Testit me shkrim, procedura e Intervistimit të kandidatëve për prokuror të shtetit, ka filluar me datë 10.11.2025 deri me datë 17.11.2025, kur është ndërprerë dhe shtyrë në afat të pacaktuar.

KPK në Takimin e 280-të të mbajtur me datë 11.12.2025 ka shqyrtuar propozimin e Komisionit për Rekrutimin e Prokurorëve të Shtetit, të datës 04.12.2025, për vlerësimin e mundësisë së anulimit të procesit të rekrutimit të 21 [njëzetenjë] Prokurorëve të Shtetit në Prokuroritë Themelore të Republikës së Kosovës, i shpallur me Vendimin **KPK/nr.311/2025,** të datës 30.04.2025

Gjatë shqyrtimit të procesit të rekrutimit të prokurorëve të shtetit, i zbatuar deri më tani, KPK ka konstatuar një mori parregullsish procedurale dhe mospërputhje me kriteret dhe standardet e përcaktuara në Rregullore, të cilat kanë cenuar zhvillimin e rregullt të procedurës dhe kanë ndikuar drejtpërdrejt në pabarazinë e kandidatëve, integritetin dhe kredibilitetin e tërësishëm të procesit të përzgjedhjes dhe rrekrutimit, parime themelore këto të përcaktuara në n.4 të Rregullores.

Shqyrtimi i këtij propozimi, është kryer në kuadër të detyrimit të përgjithshëm institucional që ka KPK për garantimin e ligjshmërisë, transparencës dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve, në kontekstin e tërësishëm të gjendjes faktike të konstatuar gjatë zhvillimit të kësaj procedure.

Edhe pse në pikëpamje procedurale, procesi i rekrutimit të prokurorëve të shtetit, nuk ishte i përfunduar, evidentimi i parregullsive, ka bërë të pamundshme renditjen apo vlerësimin përfundimtar të kandidatëve të paraqitur, në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren.

Në Takimin e cekur, KPK pas hapjes së debatit për këtë pikë të rendit të ditës dhe argumentimit të të gjithë anëtarëve të vet, me shumicë të votave të të gjithë anëtarëve të tij, erdhi në përfundim se është e pamundshme që procesi të sanohet apo të rivendoset, andaj opsioni i vetëm ligjor dhe logjik, rezultoi anulimi i tërësishëm i procesit të rekrutimit.

KPK konstatoi se procedura e rekrutimit nuk është zbatuar deri në fazën preliminare të vlerësimit dhe nuk ka rezultuar me lidhje të kontratës, andaj, rrjedhimisht nuk është krijuar e drejtë subjektive për asnjërin nga kandidatët. Kandidatët kanë pasur pritje legjitime, pa të drejtë të fituar në kuptim të ligjit.

Në takimin e cekur, KPK, pas një rivlerësimi të brendshëm institucional ka konstatuar se vazhdimi i procedurës në formën aktuale nuk i përgjigjet më nevojave organizative dhe prioriteteve funksionale të institucionit, si dhe nuk i shërben në mënyrë optimale interesit publik dhe si organ që ka iniciuar procedurën, ka kompetencë dhe detyrim ligjor që *ex-officio* të rishqyrtojë dhe të ndërpresë procedurat administrative të saj, për sa kohë që nuk është krijuar marrëdhënie juridike përfundimtare.

KPK, si organ kolegjial dhe vendimmarrës, ka detyrim ligjor që të parandalojë prodhimin e pasojave juridike nga një procedurë e zbatuar në kundërshtim me Ligjin dhe Rregulloren, ndërkaq ndërhyrja e Këshillit në këtë fazë, përbën ushtrim të kompetencës korrigjuese dhe garantuese të ligjshmërisë, drejtësisë, meritës dhe barazisë.

KPK ka konstatuar se parregullsitë e evidentuara nuk mund të korrigjohen përmes përsëritjes së pjesshme të ndonjë faze të rekrutimit apo përmes masave tjera të pjesshme sanuese, pasi një ndërhyrje e tillë do të krijonte trajtim të diferencuar ndërmjet kandidatëve dhe do të cenonte më tej parimin e barazisë në konkurrim. Për këtë arsye, anulimi i plotë i procesit është vlerësuar të jetë masa e vetme e ligjshme, e nevojshme dhe proporcionale për rivendosjen e rregullsisë procedurale, duke evituar pasojat e një procesi të cenueshëm.

Duke qenë se vendimi ka për objekt anulimin e plotë të procesit të rekrutimit dhe nuk është arritur në fazën e shpalljes së rezultateve preliminare të provimit, sipas përcaktimeve të n.28 të Rregullores, nuk lind e drejta e ankimimit të kandidatëve ndaj fazave të provimit të zbatuara deri në anulimin e procesit të rekrutimit. Nga të cekurat, vendimi ka efekt shfuqizues dhe nuk krijon pasoja të dëmshme në të drejtat e kandidatëve, pasi që ata nuk kanë fituar asnjë status që ju garanton mbrojtje gjyqësore.

Rrjedhimisht, nga rrethanat e cekura, KPK erdhi në përfundim se vazhdimi i procesit të rekrutimit të prokurorëve të shtetit, sipas konkursit të cekur, është ligjërisht i pamundshëm dhe se e vetmja mundësi për ta rikthyer ligjshmërinë e procesit, është anulimi i tij i tërësishëm.

Nga faktet e prezantuara dhe në pajtim me bazën ligjore të cekur, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ardian HAJDARAJ

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Këshillë juridike:
Ndaj këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.

Vendimi i dërgohet:
- Komisionit për Rekrutim;
- Komisionit për Rishqyrtim;
- Sekretariatit;
- Arkivit të KPK-së.